



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.603/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Komunën e Pejës, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.02.2025, merr këtë:

## V E N D I M

**PRANOHEN TË BAZUARA** ankesat Anr.603/2025, dhe Anr.605/2025, të datës 22.02.2025, të parashtruara nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në komunën e Pejës, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, ashtu që **urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), respektivisht Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), që fletëvotimet në vendvotimin-kutia e votimit më numër 1707/06 dhe 1722/03, të vlerësohen si të vlefshme dhe të njëjtat të rinumërohen dhe të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

## A r s y e t i m

Me datë 22.02.2025, PZAP-i, ka pranuar dy ankesa nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje, në të cilën theksohet se më 21 shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Pejë, gjatë procesit të numërimit të votave në Sallën e Sporteve "Karagaçi" në Pejë, ka vërejtur dhe ka informuar Qendrën në Prishtinë se fletëvotimi nga Vendvotimi më numër 1707/06 dhe 1722/03, janë shpallur të pavlefshme nga komisionerët përkatës, përkundër reagimit të vëzhguesve se Fletëvotimi ka qenë në përputhje me nenin 16 të Rregullores zgjedhore nr. 12/2024 votimi, numërimi në vendvotim dhe menaxhimi i vendvotimit. E gjithë kjo për faktin se në këto dy Fletëvotime është vendosur shenja Tik në hapësirën për subjektin politik LVV me depërtim të lehtë të vijës jashtë katorrit, mirëpo asnjëherë në kundërshtim me

rregullat zgjedhore. Pra, në Fletëvotime vërehet qartë qëllimi i votuesit se për cilin subjekt ka votuar, dhe e cila është në përputhje të plotë me nenin 16 të Rregullores zgjedhore nr.12/2024 votimi, numërimi në vendvotim dhe menaxhimi i vendvotimit. Si dëshmi ka bashkangjitur fletëvotimin nga vendvotimi përkatës.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, e njëjta jep sqarimet si më poshtë: bazuar në nenin 3, paragrafi 1.38 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Qendra Komunale e Numërimit (QKN) është institucioni përgjegjës për numërimin e fletëvotimeve në mënyrë transparente, në prani të vëzhguesve dhe personave të tjerë të akredituar. Po ashtu, sipas nenit 5, paragrafi 1.4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 Qendra Komunale e Numërimit, ndër funksionet e QKN përfshihet edhe numërimi i fletëvotimeve dhe votave të kandidatëve të subjekteve politike. Në lidhje me vlefshmërinë e fletëvotimeve, neni 16, paragrafi 2 i Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024 Votimi, Numërimi Në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, përcakton se një votë është e vlefshme kur është shënuar vetëm një subjekt politik dhe kuptohet qartë vullneti i votuesit. Në të kundërtën, vota konsiderohet e pavlefshme nëse janë shënuar më shumë se një subjekt politik, nuk është shënuar asnjë subjekt politik, janë shënuar vetëm kandidatët, por jo subjekti politik, qëllimi i votuesit nuk është i qartë. Më tutje në përgjigje njoftuan, se me datën 21.02.2025, në ora 23:30 është përmbyllur procesi i numërimit të votave të kandidatëve për deputetë dhe verifikimit të votave të subjekteve politike nga formularët e plotësuar në vendvotime më 9 shkurt 2025, në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në komunën e Pejës dhe i gjithë materiali zgjedhor duk përfshirë edhe kamerat e sigurisë, të përdorura për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 09 shkurt 2025, janë dorëzuar nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) e komunës së Pejës më datën 22.02.2025, në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, në paragrafi 5.5 të Rregullores Nr. 01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 par.1 të Ligjit Nr.05/1,-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si në vijim: A.nr.603/2025 dhe A.nr.605/2025, të datës 22.02.2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët Anr.603/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga i njëjti subjekt politik për shkeljen e njëjtë, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, përgjigjet në ankesë ka gjetur se:

#### **Ankesat janë të bazuara.**

Paneli i vlerësoi si të bazuara pretendimet e parashtruara në ankesë nga subjekti politik LVV, ku gjatë procesit të numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Komunën e Pejës gjegjësisht në Sallën e Sporteve "Karragaçi" në Pejë, fletëvotimi nga vendvotimi më numër 1707/06 dhe 1722/03, janë shpallur të pavlefshme nga komisionerët

përkatës, e gjithë kjo për faktin se në këto fletëvotime është vendosur shenja “Tik” në hapësirën për subjektin politik LVV, me depërtim të lehtë të vijës jashtë katrorit.

Paneli ka analizuar pretendimet ankimore dhe provat e paraqitura më saktësisht fotografitë e fletëvotimeve, po ashtu edhe përgjigjen në ankesë nga KQZ dhe ka ardhur në përfundim se pretendimi i ankuesit - subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje është i bazuar, dhe se nga ana e Qendrës Komunale të Numërimit (QKN) në Pejë, fletëvotimet në fjalë janë shpallur gabimisht të pavlefshme, në kundërshtim me dispozitën ligjore nga neni 16 par. 2 të Rregullores Nr.12.2024, për të cilën e urdhëroi KQZ-në, që të njëjtat fletëvotime ti konsideron si të vlefshme, ti rinumëroj dhe ti përfshijë në rezultat.

Nga fletëvotimi kuptohet qartë qëllimi i votuesit, nga se është votuar vetëm një subjekt politik, pasi që shenja (Tiku) tërësisht është i vendosur në katrorin pranë numrit 118 Lëvizja Vetëvendosje, ndërsa prekja e vijës së katrorit më lartë, nuk e bënë të pavlefshme këtë fletëvotim. Nga fletëvotimi kuptohet qartë se votuesi ka votuar vetëm për një subjekt politik dhe atë subjektin politik me numër 118, që në rastin konkret ka qenë subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje.

Sipas dispozitave të nenit 16 par. 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024, konstaton se votat konsiderohen të pavlefshme vetëm në rastet si në vijim: *“Votohet më shumë se një subjekt politik, nuk votohet asnjë subjekt politik, votohet vetëm kandidati e jo subjekti politik, dhe qëllimi i votuesit nuk është i qartë sipas procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim”*. Prandaj, në rastin konkret fletëvotimi i cili është shpallur i pavlefshëm nuk hyn në kategorinë e fletëvotimeve të pavlefshme siç parasheh dispozita ligjore e lartcekur, andaj Paneli vlerësoi se këto fletëvotime janë shpallur gabimisht të pavlefshme dhe në kundërshtim me dispozitën ligjore nga neni 16 par.3 i rregullore Nr.12.2024, për të cilën e urdhëroi KQZ-në, përkatësisht Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), që të njëjtat ti konsideroi si të vlefshme, ti rinumëroi dhe ti përfshijë në rezultatin përfundimtar, pasi që tani i gjithë materiali zgjedhor është dorëzuar në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve.

Nga të gjitha këto arsye e duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par. 4, lidhur me nenin 118 par. 1 të LZP-së, lidhur me nenin 13 par.10 nënpar.10.1 të Rregullores së PZAP-së (Nr.01/2024), u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Anr.603/2025, datë 24.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.